

KËSHILLI I ETIKËS I UGJ

- Është organ kolegjal vendimmarrës, i cili promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, cenimin e integritetit dhe interesave institucionale, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale;
- Shqyrton dhe merr vendim në lidhje me veprimtari të personelit akademik, ndihmësakademik dhe atij administrativ, nëse përbëjnë shkelje të etikës;
- Përbëhet nga një përfaqësues i personelit akademik për çdo njësi kryesore, një përfaqësues nga personeli administrativ, një nga personeli ndihmës-akademik dhe një përfaqësues i studentëve. Kur numri i anëtarëve bie çift, i shtohet një anëtar sipas propozimit të Senatit Akademik;
- Anëtarët e Këshillit të Etikës i UGJ: vetëkandidohen dhe zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash nga Senati Akademik; duhet të kenë përvojë pune në njësinë përkatëse prej të paktën 5 vitesh; kanë mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje; nuk ushtrojnë funksione drejtuese në UOGJ; zgjedhin kryetarin;
- Këshillit të Etikës i UGJ vihet në lëvizje me kërkesë të autoriteteve drejtuese në UGJ apo çdo personi të interesuar që ka lidhje me veprimtarinë institucionale;
- rastet kur Këshillit të Etikës i UGJ konstaton shkelje të etikës në institucion dhe ndaj institucionit përbëjnë shkak për marrjen e masave disiplinore;
- Këshillit të Etikës i UGJ shprehet me rekomandime drejtuar Rektorit;
- Organizimi dhe funksionimi përcaktohet në kodin e etikës së UGJ-së dhe rregulloren e Këshillit të Etikës të UGJ, të cilat miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.